# Ervin Karanxha

PROKUROR NË PROKURORINË E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Deklaratat e analizuara:

**15 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




Pasuria bruto është rritur 45.7 herë.

+ 1,388,728 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë nga fillimi I detyrës deri me datë 31.12.2017.

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete në Cash







Pasuritë e Paluajtshme

## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të Ardhurat 2004-2017 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni | 13,824,786 | 60.2% |
| Të ardhura nga paga e familjarëve | 9,017,337 | 39.2% |
| Të ardhura nga mësimdhënia | 30,000 | 0.1% |
| Të ardhura të tjera | 106,220 | 0.5% |
| Total | 22,978,343 | 100% |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

**1 deklaratë Me Probleme**
**13 deklarata Pa Probleme**

Subjekti Ervin Karanxha rezulton me pamjaftueshmëri të burimeve financiare për të mbuluar shtesën e aseteve në vitin 2011 në vlerën 215,847 lekë, pa llogaritur shpenzimet vjetore për konsum familjar.

Në vitin 2009, bashkëshortja e subjektit deklaron si person i lidhur një apartament banimi të blerë në vitin 2005 me vlerë 39,000 euro. Si burim financimi për këtë apartament, ajo deklaron vetëm një kredi bankare prej 2,500,000 lekë. Gjithashtu në vitin 2010, deklarohet shlyerja e kësaj kredie përmes një kontrate huaje me vlerë 1,200,000 lekë.

Në vitin 2011, subjekti deklaron shtesë apartament banimi me sipërfaqe 114.5 m2 në Berat me vlerë 6,000,000 lekë, por në qershor të vitit 2011, kontrata është revokuar. Më 1 tetor është blerë apartament banimi me sipërfaqe 90.12 m2, me vlerë 8,200,000 lekë në Tiranë, me burim financimi 1,000,000 lekë kursime të akumuluara dhe 5,000,000 lekë kredi bankare.

Në fund të vitit 2017 sipas deklarimeve, subjekti Ervin Karanxha rezulton me gjendje Cash progresive në vlerë 6,296,515 lekë. Nga kjo gjendje, 35,000 dollarë i përkasin babait të deklaruesit, 409,625 lekë bashkëshortes dhe diferenca janë kursime të akumuluara ndër vite të deklaruesit.